

PROGRAMI I MBROJTJES SË SHITËSIT TË PAYPAL

Përditësuar për herë të fundit më 26 nëntor 2024

Çfarë i plotëson kushtet

Nëse i shisni një blerësi një mall ose shërbim, mund t'i plotësoni kushtet për programin e mbrojtjes së shitësit të PayPal, kushtet e përgjithshme të të cilit janë përcaktuar këtu dhe janë pjesë e **marrëveshjes së përdoruesit**. Në rastet kur aplikohet, programi i PayPal për mbrojtjen e shitësit ju jep të drejtën e përfitimit të shumës së plotë të blerjes. PayPal përcakton nëse pretendimi juaj i plotëson kushtet në programin e PayPal për mbrojtjen e shitësit. PayPal do të marrë një vendim, sipas gjykimit të tij, duke u bazuar në kërkesat e pranueshmërisë, në çdo informacion ose dokumentacion të siguar gjatë procesit të zgjidhjes, ose në çdo informacion tjetër që PayPal e konsideron të rëndësishëm dhe të përshtatshëm sipas rrethanave. Nuk ka asnjë kufizim në numrin e pagesave të që i plotësojnë kushtet për programin e PayPal për mbrojtjen e shitësit. Duke hyrë në faqen e detajeve të transaksionit në llogarinë tuaj në PayPal mund të shihni transaksionet e juaja që mund të kualifikohen për mbrojtje sipas këtij programi.

Programi i PayPal për mbrojtjen e shitësit mund të aplikohet kur një blerës pretendon se:

- Nuk kanë autorizuar apo përfituar nga fondet e dërguara nga llogaria e tyre në PayPal (referuar si "**Transaksion i paautorizuar**") dhe transaksioni i paautorizuar realizohet në një mjedis të organizuar nga PayPal; ose
- Nuk e kanë marrë artikullin nga ju (referuar si pretendim "**Artikulli nuk është marrë**"), përveç se kur pretendimi "Artikulli nuk është marrë" vjen si rezultat i depozitimit të një kërkesë për kthim parash nga blerësi me lëshuesin për transaksion të bërë me kartë, ai nuk do të jetë i pranueshëm për programin e PayPal-it "Mbrojtja e shitësit".

Programi i PayPal-it "Mbrojtja e shitësit" mund të zbatohet gjithashtu kur një transaksion është kthyer si pasojë e kthimit të pagesës me sukses nga blerësi pasi ata nuk e autorizuan pagesën e kryer me kartë ose në rastet kur një pagesë e kryer me bankë kthehet nga banka e blerësit.

Ky seksion përshkruan mënyrën e zbatimit nga ana juaj të programit të PayPal për mbrojtjen e shitësit, por ju duhet të njiheni me **ndikimin që kanë te shitësit proceset e ndryshme të mbrojtjes së blerësit**.

Kërkesat bazë

Për t'i plotësuar kushtet për programin e PayPal për mbrojtjen e shitësit, duhet të përmbushen të gjitha kërkesat e mëposhtme bazë, si dhe çdo kërkesë e zbatueshme shtesë:

- Ju na jepni një **vërtetim të dërgesës ose vërtetim të dorëzimit** të vlefshëm.
- Në rastin e një pretendimi për transaksion të paautorizuar, duhet të siguroni vërtetim të vlefshëm të dërgesës ose vërtetim të dorëzimit që demonstroi se artikulli u dërgua ose iu siguroi blerësit jo më vonë se dy ditë pasi PayPal ju njoftoi për mosmarrëveshjen ose kthimin. Për shembull, nëse PayPal ju njofton rreth një pretendimi për transaksion të paautorizuar më 1 shtator, për t'i plotësuar kushtet në programin e mbrojtjes së shitësit të PayPal, vërtetimi i vlefshëm i dërgesës duhet të tregojë se artikulli iu dërgua blerësit jo më vonë se data 3 shtator.
- Artikulli duhet të jetë artikull material me përjashtim të atyre që janë subjekt i **Kërkesave shtesë për artikujt jomaterialë**.
- Artikulli duhet të transportohet në adresën e dorëzimit të paraqitur në faqen e detajeve të transaksionit në llogarinë në PayPal që përdorni për transaksionin. Nëse e dërgoni fillimisht artikullin në adresën e dorëzimit të marrësit që ndodhet në faqen e detajeve të transaksionit por më pas artikulli ridrejtohet në një adresë tjetër, atëherë nuk do të jeni i pranueshëm për mbrojtjen e shitësit të PayPal. Për këtë arsye, rekomandojmë që të mos përdorni një shërbim transporti të organizuar nga blerësi, në mënyrë që të paraqisni vërtetim të vlefshëm të transportit dhe dërgimit.
- Kërkesave të PayPal për dokumentacion dhe informacione të tjera duhet t'i përgjigjeni në kohën e duhur, siç kërkohet në korrespondencën me email ose në korrespondencën përmes **Qendrës së zgjidhjeve**. Nëse nuk i përgjigjeni në kohën e duhur kërkesave të PayPal për dokumentacion ose informacione të tjera, nuk mund t'i plotësoni kushtet për mbrojtjen e shitësit të PayPal.
- Nëse shitja përfshin mallra të rezervuar ose me porosi, duhet t'i dërgoni brenda afatit të specifikuar në listim. Në të kundërt, rekomandohet dërgimi i të gjithë artikujve brenda 7 ditëve nga marrja e pagesës.
- Duhet të pranoni një pagesë nga një llogari në PayPal për blerjen (nuk përfshihen pagesa e pjeshme dhe/ose pagesa me këste).
- Kur keni integruar një produkt të Arkës së PayPal me faqen tuaj të internetit ose aplikacionin, kërkesat e mëposhtme zbatohen për Shitësit e Bizneseve që përdorin një llogari PayPal për aktivitetin tregtar, për të siguar një menaxhim optimal të transaksioneve potencialisht mashtruese:

- Ju duhet të përdorni versionin aktual të atij produkti të Arkës së PayPal nëse jeni duke pranuar pagesa drejtpërdrejt nga një faqe interneti ose aplikacion. Ne ju inkurajojmë të keni kujdes përditësimet pasi mund të njoftojmë ose lajmërojmë herë pas here dhe të përditësoni menjëherë atë produkt të Arkës së PayPal.
- Duhet të garantoni transmetimin e informacionit e kërkuar të sesionit të PayPal në arkë, nëse jeni integruar në PayPal përmes një pale të tretë ose përmes një aplikacioni lokal. Transmetimi i këtyre informacioneve është i nevojshëm për PayPal për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet potencialisht mashtruese.
- Kërkesa të tjera integrimi mund të zbatohen për Shitësit që operojnë sipas modeleve të biznesit me rrezik të lartë. Këto kërkesa janë vendosur për të siguruar respektimin e standardeve të rritura të sigurisë dhe menaxhimit të rrezikut të PayPal, duke zbutur kështu rreziqet potenciale lidhur me transaksionet mashtruese të lidhura me këto modele biznesi. PayPal do t'ju informojë paraprakisht për këto kërkesa dhe do t'ju jepet një afat kohor i arsyeshëm për të bërë çdo ndryshim të nevojshëm.
- Në rastin e pretendimeve për **Transaksion të paautorizuar**, pagesa duhet të shënohet si "e pranueshme" ose "pjesërisht e pranueshme" për programin e PayPal-it "Mbrojtjen e shitësit" në faqen e "Detajeve të transaksionit".

Kërkesa të mëtejshme për "artikulli nuk është marrë"

Për t'i plotësuar kushtet për programin e PayPal "Mbrojtjen e shitësit" për një pretendim "Artikulli nuk është marrë" nga ana e blerësit, ju duhet të përmbushni kërkesat bazë dhe atë shtesë të renditura më poshtë:

- Duhet të jepni **vërtetimin e dorëzimit** siç përshkruhet më poshtë.

Kërkesa shtesë për mallrat jomateriale

Që shitja e mallrave dhe shërbimeve jomateriale t'i plotësojë kushtet për mbrojtjen e shitësit të PayPal, shitja duhet të plotësojë **kërkesat themelore** dhe kërkesat e mëposhtme shtesë:

- Në rastin e pretendimeve për **Transaksion të paautorizuar**, PayPal ka shënuar transaksionin për mallra jomateriale si "i pranueshëm" në faqen e "Detajeve të transaksionit" ose ka dhënë njoftim tjetër për pranueshmërinë me shkrim.
- Dorëzoi artikullin dhe siguroi **Vërtetim i dërgesës ose dorëzimit për mallra jomateriale**.

Krijimi i vërtetimit të dërgesës ose vërtetimit të dorëzimit

Mallrat fizikë	
Në vijim paraqiten dokumentet që shërbejnë si vërtetim dërgese ose dorëzimi për mallrat fizikë:	
Vërtetimi i dërgesës	Vërtetimi i dorëzimit

<p>Dokumentacion online ose fizik nga kompania e transportit ku përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një numër gjurmimi i verifikueshëm dhe online Data e transportit Adresa e marrësit, e cila përkon me adresën e dorëzimit në faqen e detajeve të transaksionit Adresa e marrësit ku tregohet të paktën qyteti, shteti ose kodi ZIP (ose ekuivalenti në nivel ndërkombëtar). 	<p>Dokumentacion online ose fizik nga kompania e transportit ku përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një numër gjurmimi i verifikueshëm dhe online Data e dorëzimit dhe statusi "dorëzuar" i artikullit ose shërbimit. Adresa e marrësit ku tregohet të paktën qyteti, shteti ose kodi ZIP (ose ekuivalenti në nivel ndërkombëtar). Konfirmimi i nënshkrimit, në rast se shuma e plotë e pagesës (duke përfshirë transportin dhe tatimet) tejkalon shumë fikse (bazuar në monedhën e pagesës) të cilësuar në tabelën e vlerave kufi për konfirmimin e nënshkrimit. Konfirmimi i nënshkrimit është një dokument online, i cili mund të shihet në faqen e internetit të kompanisë së transportit, dhe tregon se është nënshkruar për artikullin në fjalë (përveçse për shitësit që kanë llogari në PayPal të regjistruar në Shqipëri, Andorra, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Ukrainë, për të cilët nuk zbatohet kjo kërkesë). <p>E RËNDËSISHME: Përzgjedhja e kompanisë së transportit dhe e opsioneve të saj të transportit mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në aftësinë tuaj për të përmbushur kërkesat për vërtetimin e dorëzimit. Sigurohuni, veçanërisht kur dërgoni mallra ndërkombëtarisht, që transportuesi juaj mund të sigurojë statusin e "dorëzuar" në adresën e duhur, ose pretendimi juaj për mbrojtjen e shitësit mund të refuzohet.</p>
---	---

<p>Mallrat jomaterialë</p> <p>Në vijim paraqiten dokumentet që shërbejnë si vërtetim i dërgesës ose i dorëzimit për mallrat jomaterialë:</p> <p>Për mallrat jomaterialë ose dixhitalë, vërtetimi i dërgesës ose i dorëzimit është prova bindëse ku tregohet se artikulli është dorëzuar ose se porosia e blerjes është përmbushur. Prova bindëse mund të përfshijë një sistem të dhënash ku tregohet data e dërgimit të artikullit dhe se:</p> <ul style="list-style-type: none"> Artikulli i është dërguar marrësit në mënyrë elektronike, duke përfshirë adresën e marrësit (email, IP, etj.), sipas rastit; ose Artikulli është marrë ose aksesuar nga marrësi
--

Vlerat kufi të monedhave për konfirmimin e nënshkrimit

Monedha	Vlera e transaksionit	Monedha	Vlera e transaksionit
Dollari australian:	850 AUD	Dollari i Zelandës së Re:	950 NZD
Reali brazilian:	1750 BRL	Korona norvegjeze:	4600 NOK
Dollari kanadez:	850 CAD	Peso filipinase:	34 000 PHP
Korona çeke:	15 000 CZK	Zlota polake	2300 PLN
Korona daneze:	4100 DKK	Rubla ruse:	27 000 RUB
Euro:	550 EUR	Dollari i Singaporit:	950 SGD

Dollari i Hong-Kongut:	6000 HKD	Korona suedeze:	4950 SEK
Forinti hungarez:	170 000 HUF	Franga zvicerane:	700 CHF
Shekeli izraelit:	2700 ILS	Dollari i ri tajvanez:	23 000 TWD
Jeni japonez:	77 000 JPY	Bahti tajlandez:	24 500 THB
Ringiti malajzian:	2500 MYR	Paundi britanik:	450 GBP
Peso meksikane:	10 000 MXN	Dollari amerikan:	750 USD

Artikujt dhe transaksionet dhe që nuk i plotësojnë kushtet

Artikujt ose transaksionet e mëposhtme **nuk** i plotësojnë kushtet për programin e PayPal për mbrojtjen e shitësit:

- Pasuri të patundshme, përfshi pronë banimi
- Automjete, përfshi, por pa u kufizuar në një automjet motorik, motoçikleta, automjete për qëllime rekreative, aeroplanë ose barka, me përjashtim të automjeteve të lehta portative të përdorura për qëllime rekreative, si biçikleta dhe skuter balancues elektrik
- Biznese (blerja ose investimi në një biznes)
- Makineri industriale të përdorura në industrinë e prodhimit
- Pagesa ekuivalente me para në dorë, përfshi artikuj me vlerë monetare, si kartat dhuratë dhe kartat e parapaguara
- Pagesa të bëra në lidhje me arin (qoftë në formë fizike ose në formë investimi në treg)
- Produkte financiare ose investime të çfarëdo lloji
- Token i pakëmbyeshem (NFT) me një shumë transaksioni prej:
 - 10,000.01 USD ose më shumë (ose vlera ekuivalente në monedhën vendase siç llogaritet në momentin e transaksionit);
 - 10,000.00 USD ose më pak (ose vlera ekuivalente në monedhën vendase siç është llogaritur në momentin e transaksionit), përveç se nëse blerësi pretendon se ishte një **Transaksion i Paautorizuar** dhe transaksioni përmbush të gjitha kërkesat e tjera të pranueshmërisë.
- Kumar, lojëra fati dhe/apo çdo aktivitet tjetër që ka një tarifë për të hyrë dhe një çmim
- Donacionet, duke përfshirë pagesat e marra si financim kolektiv apo huadhënie me pjesëmarrje
- Pagesat ndaj një enti shtetëror (me përjashtim të ndërmarrjeve shtetërore), një agjencie qeveritare ose palëve të treta që mbledhin pagesa në emër të enteve shtetërore ose agjencisë qeveritare
- Pagesa ndaj çdo shërbimi për pagesën e faturave
- Artikuj kur blerësi pretendon (qoftë nëpërmjet nesh ose lëshuesit të kartës së tyre) se artikulli që i dërguat nuk është ai që kishte porositur (referuar si një pretendim "**Shumë ndryshe nga përshkrimi**")
- Pretendimet **Artikulli nuk është marrë** të bëra nga blerësi juaj drejtpërdrejt me lëshuesin e tij të kartës
- Artikuj fizikë dhe materialë të dorëzuar personalisht, duke përfshirë në lidhje me një pagesë të kryer në dyqanin tuaj fizik, përveç rastit kur blerësi ka paguar për transaksionin personalisht duke përdorur kodin QR të PayPal për mallrat dhe shërbimet
- Çdo gjë që PayPal përcakton, sipas gjykimit të tij të vetëm, që është e ndaluar nga **Politika për përdorimin e pranueshëm** e PayPal, edhe nëse transaksioni fillimisht është shënuar si "i plotëson kushtet" ose "i plotëson kushtet pjesërisht" në faqen e detajeve të transaksionit.
- Pagesat e bëra duke përdorur pagesat me PayPal (më parë e njohur si pagesë në grup)
- Pagesat personale, përfshi pagesat e dërguara duke përdorur funksionin "miqtë dhe familja" e PayPal
- Pagesat që nuk përpunohen përmes një llogarie blerësi' në PayPal, duke përfshirë pagesat me llogari vizitori dhe pagesat standarde të kartave të debitit dhe kreditit ku llogaria e shitësit' është regjistruar në vendet e mëposhtme – Singapori, Kina, Hong Kongu, Australia, Italia, Franca, Holanda, Spanja, Irlanda, Polonia, Suedia, Bullgaria, Austria, Portugalia, Belgjika, Norvegjia, Greqia, Danimarka, Qipro, Lituania, Çekia, Estonia, Finlanda, Rumania, Sllovenia, Hungaria, Sllovakia, Malta, Letonia dhe Luksemburgu. Pagesatme llogari vizitori dhe pagesat standarde të kartave të debitit dhe kreditit të marra nga llogaritë e regjistruara në të gjitha vendet e tjera janë përndryshe të pranueshme për Mbrojtjen e Shitësit.
- Artikujt të dërguar pasi PayPal ju këshilloi të mos e lëshoni artikullin
- Bileta udhëtimi të shitura nga një kompani transporti ku (1) blerësi pretendon (qoftë me ne apo institucionin e tyre financiar) se ishte një **Transaksion i paautorizuar** dhe (2) një pretendim i tillë ishte depozituar më shumë se 24 orë para datës së udhëtimit.

